

VENDIM
Nr. 241, datë 15.11.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKGAZ”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR
(SHITJE ME SHUMICË)**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 2, germa “ç” dhe të nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; si dhe të nenit 4, pika 1, germa “ç”; të neneve 5; 8 dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017; të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 704 prot., datë 5.11.2018, shoqëria “Balkgaz” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror.

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, pikat “i”, “ii”, “iii” dhe “iv”: plotësuar.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale: është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, germa “e”, pikat “ii”, “v”, “vi”: plotësuar.

- Dokumente specifike për llojin e licencës: është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

- Neni 9, pika 2, gerrat “i” dhe “iii”: plotësuar; germa “ii”: plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

- Germën “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale”; pikën “i” (Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit); pikën “vi” (Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi).

- Pikën 2, “Dokumente specifike për llojin e licencës”, germa “ii” (Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit), do të njoftohet subjekti që në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë të aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti